



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Anketa e Fuqisë Punëtore TM1 - 2017



Parathënie

Qëllimi i Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) në Kosovë është të ofrojë të dhëna statistikore mbi indikatorët statistikorë të tregut të punës dhe të mundësojë krahasimin e tyre me vitet paraprake. Anketa e Fuqisë Punëtore përfshin 589 Qarqe Regjistruese (QR) në tërë territorin e Kosovës.

Raporti mbi AFP-në, në tremujorin e parë të vitit 2017 përmban të dhëna mbi punësimin dhe papunësinë sipas moshës, gjinisë, gjendjen e punësimit, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe fushave të tjera të tregut të punës.

Në tremujorin e parë të 2017, shkalla e punësimit është 28.9 %, shkalla e papunësisë është 30.5 % ndërsa shkalla e jo aktivitetit është 58.3 %.

Të dhënat e AFP-së tregojnë që përqindja e personave të punësuar me orar të pjesshëm për tremujorin e parë të këtij viti është 6.6%. Vetëpunësimi (si përqindje e të punësuarve) për këtë tremujor është 23.9 %. Përqindja e të punësuarve në punë të paqëndrueshme (personat, që janë të vetëpunësuar dhe nuk kanë punonjës dhe ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar) ishte 24.1%. Tregtia, prodhimi, ndërtimtaria dhe arsimit vazhdojnë të punësojnë pothuaj gjysmën e personave të punësuar.

Sa i përket pjesëmarrjes në fuqinë punëtore që është 41.7 % në këtë periudhë, numri i femrave që i përkasin fuqisë punëtore ishte 19.8 % ndërsa meshkuj ishte 63.1 %.

Shkalla e papunësisë tek të rinjtë është 50.5 %.

Papunësia afatgjate e të rinjve (15-19), që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj për këtë tremujor është 41.4 %.

Përqindja e të rinjve që nuk janë të punësuar, as në shkollim, as në trajnim – NEET (të intervistuarit e moshës 15-24 vjeç), është 27.8 %.

Me këtë rast, ASK-ja falënderon pjesëmarrësit dhe akterët e tjerë, e posaçërisht stafin e vetë në realizimin e tremujorit të parë të AFP-së 2017. Njëkohësisht, i bën me dije të gjithë përdoruesit e statistikave zyrtare se ASK-ja, brenda mundësive buxhetore, në vazhdimësi po bën përpjekje për ngritjen e kapaciteteve për të publikuar statistika të qëndrueshme dhe sa më cilësore.

Në bazë të Ligjit të Statistikave Zyrtare Nr.04/L-034, Agjencia e Statistikave të Kosovës është përgjegjëse për prodhimin e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës, prandaj, gjatë shfrytëzimit të këtyre të dhënave, duhet të citohet burimi.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: social@rks-gov.net

Avni Kastrati - Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale

Publikimin e përgatitën:

Bujar Hajrizi - Shef i Sektorit
Bedrije Demaj - Zyrtare e lartë
Besarta Thaçi - Zyrtare

Korrik, 2017

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së
Isa Krasniqi

Hyrje

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ka filluar realizimin e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) në vitin 2001, duke vazhduar si anketë vjetore deri në vitin 2009. Për shkak të përgatitjes së regjistrimit të popullsisë, Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) nuk u realizua në vitin 2010 dhe 2011.

Nga viti 2012 Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) zhvillohet sipas metodologjisë së Eurostatit si anketë e vazhdueshme (52 javë kalendarike - javë referuese), si dhe:

- Pyetësi i përmirësuar (duke vazhduar me respektimin e udhëzuesve të Eurostat-it)
- Korniza e re e mostrës (bazuar në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe banesave të vitit 2011 në Kosovë)
- Nën-mostra longitudinale, ku çdo ekonomi familjare e përzgjedhur intervistohet katër herë (një herë në tre muaj, ku hera e parë në ekonominë familjare të përzgjedhur është Anketim dhe tri intervistat tjera si Rianketime ku përcillen ndryshimet eventuale të Indikatorëve, në atë ekonomi familjare të përzgjedhur prej tremujorit në tremujorin tjetër).
- Intervistimi i ekonomive familjare është realizuar me anë të laptopit, përkatësisht Përmes metodës CAPI – Intervista Personale me Asistencë Kompjuterike, e cila mundëson gjenerimin e të dhënave më shpejt se sa përmes metodës PAPI, përkatësisht metodës së intervistimit tradicional të mbledhjes së të dhënave me letër dhe laps, të cilat futen më pas në kompjuter.

Objektivat kryesorë të AFP-së janë grumbullimi i informatave kryesisht për anën e ofertës së tregut të punës, d.m.th. informatave mbi ata që punojnë apo që janë aktivë në kërkim të një pune.

Falenderim

Nga viti 2014, AFP-ja realizohet me buxhetin e ASK-së. Shprehim mirënjohjen tonë ndaj punës të zyrave rajonale të ASK-së, të cilët kanë mbikëqyrur punën në terren, dhe ndaj familjeve, që kanë ndarë kohën e tyre dhe kanë ofruar të dhëna duke ndihmuar në këtë mënyrë mbledhjen e këtyre informacioneve të detajuara.

Shkurtesat

AFP	-	Anketa e Fuqisë Punëtore
ONP	-	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
NACE	-	Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike
ISCO	-	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve
QR	-	Qark Regjistruar
NEET	-	Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo trajnim

Përmbajtja

	Faqe
Parathënie	1
Hyrje	2
Falenderim.....	3
Shkurtesat	4
Definicione.....	7
Treguesit kryesorë	10
Tab. 1: Indikatorët kryesorë të tregut të punës	12
1. Punësimi.....	13
1.1: Punësimi sipas gjinisë.....	13
1.2: Punësimi sipas grupmoshës dhe nivelit arsimor.....	13
Tab.1.1: Numri i të punësuarve dhe shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grupmoshës.....	14
Tab. 1.2: Punësimi sipas nivelit arsimor	14
Tab. 1.3: Niveli më i lartë arsimor sipas llojit të punëdhënësit (15-64)	15
1.3: Statusi i punësimit.....	15
Tab. 1.4: Statusi i punësimit sipas gjinisë (%)	15
1.4: Punësimi i paqëndrueshëm.....	15
Tab. 1.5: Punësimi i paqëndrueshëm sipas gjinisë	16
Tab. 1.6: Punësimi i paqëndrueshëm sipas profesionit dhe gjinisë	16
Tab. 1.7: Punësimi i paqëndrueshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë.....	17
1.5: Llojet e kontratave.....	17
1.6: Punësimi sipas aktiviteteve	17
Tab. 1.8: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në mijëra)	18
Tab. 1.9: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në %).....	18
1.7: Punësimi sipas profesioneve.....	19
Tab. 1.10: Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë (në %)	19
1.8: Modelet e punës	20
Tab. 1.11: Arsyet e të punuarit me orar të pjesshëm sipas gjinisë (%)	20
Tab. 1.12: Punësimi sipas orëve të punës në javë dhe sipas gjinisë	20
Tab. 1.13: Numri mesatar i orëve të punuara në javë sipas llojit të punëdhënësit dhe gjinisë	21
Tab. 1.14: Modelet e punësimit sipas gjinisë.....	21
1.9: Paga mujore neto.....	22
2. Papunësia.....	23
2.1: Papunësia sipas gjinisë.....	23
Tab. 2.1: Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë	23
2.2: Papunësia sipas grup moshës dhe nivelit arsimor.....	24
Tab. 2.2. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grup moshës.....	24
Tabela 2.3. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor dhe gjinisë	24
2.3: Papunësia tek të rinjtë.....	25
Tab. 2.4: Përqindja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme dhe shkalla e papunësisë tek të rinjtë sipas gjinisë	25
Tab. 2.5: Shkalla e papunësisë së të rinjve ndaj të rriturve, sipas gjinisë	25
2.4: Kohëzgjatja e papunësisë	25
Tabela 2.6: Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%).....	25
Graf. 2.2. Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%).....	26
3. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	27
Graf. 3.1: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë	27

Tab. 3.1: Fuqia punëtore dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhe grupmoshës	28
4. Personat joaktivë	29
Graf 4.1: Shkalla e pjesëmarrjes jo aktive sipas gjinisë	29
4.1: Të rinjët joaktivë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET) ..	29
Tab. 4.1: Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollë ose trajnim (NEET) sipas gjinisë	30
5. Shkallët e varësisë demografike dhe ekonomike	31
Tab. 5.1: Shkallët e varësisë demografike	31
Tab. 5.2: Shkallët e varësisë ekonomike	31
6. Saktësia e të dhënave	32
Tab. 6: Saktësia e vlerësimeve në bazë të AFP-së për tremujorin e parë të vitit 2017 në nivel vendi	32

Definicione

Popullsia në moshë pune përfshin personat e moshës 15 deri 64 vjeçare. Kjo masë përdoret për të dhënë një vlerësim të numrit të përgjithshëm të punonjësve potencialë brenda një ekonomie.

Fuqia punëtore përbëhet nga personat e punësuar dhe personat e papunë, sipas përkufizimeve të sakta, të paraqitura mëposhtëm. Personat joaktivë nuk konsiderohen pjesë e fuqisë punëtore.

1. Të punësuar: personat, të cilët gjatë javës referente kanë bërë ndonjë punë për pagesë, fitim ose përfitim familjar, në të holla ose në natyrë, ose ata që mungonin përkohësisht në punën e tyre.

2. Të papunë: personat, të cilët gjatë javës referente:

- Ishin pa punë, d.m.th. nuk ishin të punësuar me pagesë ose të vetëpunësuar;
- Aktualisht ishin të gatshëm për punë, d.m.th. ishin të gatshëm të fillojnë punë me pagesë ose vetëpunësim brenda dy javësh; dhe
- Kërkonin punë, d.m.th. kishin ndërmarrë hapa specifikë gjatë katër javëve të fundit në kërkim të punësimit me pagesë ose vetëpunësimit.

3. Persona joaktivë: personat, të cilët gjatë periudhës referente nuk ishin as të punësuar as të papunë.

Klasifikimi i popullsisë në këto tri kategori të lartpërmendura varet nga aplikimi i parimit të aktivitetit – çfarë ka bërë personi në të vërtetë gjatë javës referuese - dhe një grup rregullash prioritare mbi aktivitetin, që i japin përparësi punësimit mbi papunësinë dhe papunësisë mbi joaktivitetin ekonomik. Klasifikimi gjithashtu varet nga të kuptuarit e qartë se cilat aktivitete konsiderohen si “punësim”.

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës (të punësuar apo të papunësuar). Raporti i fuqisë punëtore (të punësuarit dhe të papunët) ndaj popullsisë në moshë pune, i shprehur si përqindje është:

$$\text{Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore} = \frac{\text{Të punësuar} + \text{Të papunë}}{\text{Popullsia në moshë pune}} \times 100$$

Shkalla e jo-aktivitetit është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që nuk bënë pjesë në fuqinë punëtore (as të punësuar as të papunë). Kur mbledhen së bashku, shkalla e jo-aktivitetit dhe ajo e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore japin rezultatin 100 për qind.

Raporti i punësimit ndaj popullsisë, i njohur edhe si shkalla e punësimit, është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që është e punësuar.

$$\text{Raporti i punësimit ndaj popullsisë} = \frac{\text{Popullsia e punësuar}}{\text{Popullsia në moshë pune}} \times 100$$

Shkalla e papunësisë është përqindja e fuqisë punëtore, që nuk është e punësuar. Fuqia punëtore përcaktohet si bazë për këtë indikator dhe jo popullsia në moshë pune.

$$\text{Shkalla e papunësisë} = \frac{\text{Të papunë}}{\text{Fuqi punëtore}} \times 100$$

Punonjës të dekurajuar janë personat që nuk kanë punë, të cilët aktualisht janë të gatshëm për punë, por që kanë hequr dorë së kërkuari punë sepse besojnë se nuk mund të gjejnë punë. Kjo kategori e personave të dekurajuar përfshihen në kategorinë e popullsisë joaktive.

Papunësia e të rinjve i referohet papunësisë së personave të moshës 15-24 vjeç.

NEET përbëjnë pjesën e të rinjve (15-24 vjeç), që nuk janë as të punësuar, nuk ndjekin as shkollim dhe as trajnim.

Punësimi i paqëndrueshëm i referohet personave të vetëpunësuar, që nuk kanë të punësuar ose punëtorëve të papaguar familjarë. Këta lloj të punësuarish kanë më pak gjasa të kenë marrëveshje formale pune dhe ka më shumë gjasa që këtyre t'u mungojnë kushtet e përshtatshme për punë.

Diagrami i mëposhtëm, ilustron kriteret, që përdoren për klasifikimin e popullsisë në moshe pune si të punësuar, të papunë, apo joaktive.

Grafiku 1: Klasifikimi i fuqisë punëtore në Anketën e Fuqisë Punëtore të Bashkimit Evropian

Person i moshës 15 vjeç e më shumë që jeton në një ekonomi familjare private


Personi ka bërë ndonjë punë për pagesë ose fitim gjatë javës referente

Personi nuk ka punuar por ka pasur një punë ose biznes prej të cilit ka munguar në javën referente

Punëtor familjar i papaguar

Person i moshës 15-74 vjeç, i cili nuk ka kërkuar punësim sepse puna e cila do të fillojë brenda 3 muajve tanimë ishte gjetur

Person i moshës 15-74 vjeç, që kërkonte punësim




Treguesit kryesorë

Grafikoni 2 paraqet një përmbledhje të gjendjes së tregut të punës të popullsisë së Kosovës duke u bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore të kuartalit të parë 2017. Ndër rezultatet kryesore të AFP-së për tremujorin e parë të vitit 2017, siç paraqitet në grafikonin 1 dhe elaborohet më tej në këtë raport, janë:

- Pothuajse dy të tretat e popullsisë së Kosovës është në moshë pune (15-64 vjeç). Pritet që popullsia në moshë pune të rritet shpejt gjatë dekadës së ardhshme pasi Kosova është ndër vendet me popullsinë më të re në Evropë.
- Nga popullsia në moshë pune, 58.3 % nuk janë ekonomikisht aktivë, që do të thotë se ata nuk janë të punësuar dhe nuk kanë qenë aktivë në kërkim të punësimit gjatë katër javëve të kaluara dhe/ose nuk janë të gatshëm të fillojnë punë brenda dy javësh.
- Nga 41.7 % e popullsisë, që është ekonomikisht aktive, 30.5 % (152,915 persona) janë të papunë. Kjo do të thotë se 69.5% (348,227) e personave ekonomikisht aktivë janë të punësuar, duke krijuar një raport punësimi ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) prej 28.9 %.
- 58.3 % e popullsisë në moshë pune, që është joaktive.
- Ekzistojnë dallime të mëdha gjinore në tërë tregun e punës.
 - Pothuaj një në pesë (19.8 %) femra në moshë pune janë aktive në tregun e punës, krahasuar me rreth tri te pestat (63.1 %) e meshkujve në moshë pune.
 - Në mesin e personave në fuqinë punëtore, papunësia është më e lartë për femrat se sa për meshkujt (34.6 % krahasuar me 29.3 %).
 - Shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 13.0 %, krahasuar me 44.6 % për meshkujt.
 - Kjo shkallë shumë e ulët e papunësisë te femrat rrjedh nga kombinimi i pjesëmarrjes shumë të ulët në fuqinë punëtore dhe papunësisë së lartë.
 - Përgjegjësitë familjare ishin arsyeja kryesore për mos-aktivitetin e femrave në tregun e punës, 38.7 % e femrave të intervistuar kanë dhënë këtë arsye.
 - Femrat ishin të punësuar kryesisht në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tregtisë (49.8 % e femrave të punësuar). Meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e prodhimit, ndërtimtarisë, dhe tregtisë (duke punësuar 43.8 % të meshkujve të punësuar).
- Papunësia tek të rinjtë është shumë e lartë në Kosovë
 - Në tremujorin e parë të vitit 2017, të rinjtë në Kosovë kishin gjasa dy herë më shumë të jenë të papunë krahasuar me të rriturit. Në mesin e personave të moshës 15-24 vjeçare dhe në fuqinë punëtore, 50.5 % ishin të papunë.

Papunësia është më e lartë te femrat e reja (60.4 %) se te të rinjtë meshkuj (46.5%).

- Pothuaj një e treta (27.8 %) e personave të moshës 15 deri 24 vjeçare në Kosovë nuk ishin në shkollim, punësim apo trajnim (NEET). Kjo shifër është 31.8 % për femrat e reja krahasuar me 24.1 % për të rinjtë meshkuj.
- Pjesa më e madhe e atyre që janë të punësuar raportojnë të punojnë me orar të plotë.
- 93.4 % e të intervistuarve raportuan se punojnë me orar të plotë në punën e tyre kryesore.
- Arsyet e të punuarit me orar të pjesshëm dallojnë midis dy gjinive, pasi gratë, duke marrë përsipër më shumë rolin e kujdesit brenda familjes, reduktojnë orët në dispozicion për punësim.
- Arsyeja numër një për meshkujt pse nuk punojnë me orar të plotë, ishte mungesa e një pune me orar të plotë.
- 24.1 % e personave të punësuar i përkiste kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm. Kjo do të thotë se ata ose janë të punësuar në biznesin e tyre (punëtorë për llogari vetanake), ose kontribuojnë në një biznes familjar (të paguar ose të papaguar).
- Vetëm 31.3 % e personave të punësuar kishin kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 68.7 % kishin kontratë të përkohshme, pa dallime sinjifikante midis meshkujve dhe femrave. Personat, që kishin kontrata të përkohshme, u pyetën se pse kishin këtë lloj kontrate dhe 97.4 % e të intervistuarve raportuan se nuk kishte kontratë tjetër në dispozicion.
- Pagat neto të shumicës së punonjësve ishin midis 400 € deri 500 € në muaj. Janë vërejtur dallime shumë të vogla gjinore.

Graf. 2: Klasifikimi i tregut të punës për popullsinë e Kosovës, TM1 2017**Tab. 1: Indikatorët kryesorë të tregut të punës**

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	63.1	19.8	41.7
Shkalla e joaktivitetit	36.9	80.2	58.3
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	44.6	13.0	28.9
Shkalla e papunësisë	29.3	34.6	30.5
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	46.5	60.4	50.5
Përqindja e të rinjve NEET në popullsinë e të rinjve (15-24 vjeç)	24.1	31.8	27.8
Përqindja e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	25.8	18.4	24.1

1. Punësimi


1.1: Punësimi sipas gjinisë

Nga e gjithë popullsia në moshë pune, 28.9 % ishin të punësuar. Shkalla e punësimit ishte më e lartë për meshkuj se sa për femra: 44.6 % të meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 13.0 % të femrave po ashtu në moshë pune.

Krahasuar me tremujorin paraprak të AFP-së (TM4-2016) në Kosovë, kemi ulje të shkallës së punësimit me 0.6 %, ku kjo ulje te meshkujt ishte 1.0 % përderisa te femrat kemi rritje për 0.1%.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM1-2016) të AFP-së në Kosovë, kemi rritje të shkallës së punësimit me 3.4 %, ku kjo rritje te meshkujt ishte 6.0 % përderisa te femrat kjo rritje është vetëm 0.8%.

Graf. 1.1: Shkalla e punësimit sipas gjinisë



1.2: Punësimi sipas grupmoshës dhe nivelit arsimor

Shkalla e punësimit nëpër grup moshë ishte më e larta në mesin e personave të moshës mes 35-44 vjeç (38.8 %) dhe më e ulta në mesin e të rinjve (15-24 vjeç) (11.2 %).

Shkalla e punësimit te femrat për grup moshat 25-54 vjeç sillet nga 15.2% deri në 18.4%. Në grup moshën 25-34 vjeç shkalla e punësimit është 15.2% ku kemi rritje 2.8 % në grup moshën 35-44 vjeç (18.0%) dhe 3.2% krahasuar me grupë moshën 45-54 vjeç (18.4%). Ndërsa femra të punësuar në grup moshën e re (15-24 vjeç), ishin vetëm 5.3% derisa në grup moshën e vjetër (55-64 vjeç) ishin 10.9 %.

Tek meshkujt (Tabela 1.1), shkalla e punësimit ishte më e larta për grup moshën 45 deri 54 vjeç (61.9%), dhe më e ulta për të rinjtë (16.6%).

Tab.1.1: Numri i të punësuarve dhe shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grupmoshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI (NË MUJËRA)			
15-24	30.3	9.1	39.4
25-34	67.5	17.6	85.1
35-44	66.4	20.8	87.2
45-54	62.6	21.4	84.0
55-64	44.0	8.5	52.5
15-64	270.9	77.3	348.2
Raporti punësim ndaj popullsisë (%)			
15-24	16.6	5.3	11.2
25-34	51.0	15.2	34.3
35-44	60.9	18.0	38.8
45-54	61.9	18.4	38.6
55-64	53.4	10.9	32.7
15-64	44.6	13.0	28.9

Tab. 1.2: Punësimi sipas nivelit arsimor

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI (NË MUJËRA)			
Pa shkollë	0.3	0.3	0.7
Fillor	46.9	14.7	61.6
Arsim i mesëm profesional	100.1	18.0	118.1
Shkollë e mesme gjimnazi	60.6	11.7	72.3
Terciar	63.0	32.5	95.6
Gjithsej	270.9	77.3	348.2
SHKALLA E PUNËSIMIT (%)			
Pa shkollë	3.9	1.5	2.1
Fillor	28.4	5.1	13.5
Arsim i mesëm profesional	48.3	15.0	36.1
Shkollë e mesme gjimnazi	45.1	12.4	31.7
Terciar	68.7	48.5	60.2
Gjithsej	44.6	13.0	28.9

Tabela 1.2 tregon që sa më i lartë të jetë shkollimi aq më e lartë do të jetë mundësia për të u punësuar (60.3%).

Tab. 1.3: Niveli më i lartë arsimor sipas llojit të punëdhënësit (15-64)

Kosovë	Sektori publik, qeveria	Ndërmarrje në pronësi	Kompani private	Individuale private
NIVELI MË I LARTË ARSIMOR (%)				
Pa shkollë	0.0	0.0	0.2	0.0
Fillor	3.2	3.8	18.0	25.4
Arsim i mesëm profesional	25.1	24.9	40.5	42.8
Shkollë e mesme gjimnazi	13.2	20.6	22.5	23.1
Terciar	58.4	50.6	18.8	8.7
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0

Tabela 1.3 tregon që kërkesat për vende pune janë më të larta për pozita qeveritare, ku mbi gjysma e të gjithë të punësuarve (58.7%) e kanë të përfunduar arsimin e lartë.

1.3: Statusi i punësimit

Në tremujorin e parë të vitit 2017, 68.3% e personave të punësuar ishin punonjës, 7.9% ishin të vetë-punësuar dhe kishin punonjës të tjerë, 16.0% ishin të vetë-punësuar pa punonjës të tjerë dhe 7.8% ishin punëtorë familjarë (Tabela 1.4). Shumica e femrave të punësuar kishin statusin e punonjësit (78.6% krahasuar me 65.4% për meshkujt).

Tab. 1.4: Statusi i punësimit sipas gjinisë (%)

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Statusi i Punësimit (%)			
Punonjës	65.4	78.6	68.3
I vetë-punësuar me punonjës	9.3	2.9	7.9
I vetë-punësuar pa punonjës	17.4	11.0	16.0
Punëtor familjar i papaguar	7.9	7.5	7.8
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

1.4: Punësimi i paqëndrueshëm

Përveç shkallës së ulët të punësimit në Kosovë, 24.1% e personave të punësuar punonin në vende pune të paqëndrueshme. Punëtorët në punë të paqëndrueshme janë ose persona të vetëpunësuar pa punonjës, ose ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar. Këto dy grupe punëtorësh kanë gjasat më të ulta të kenë një marrëveshje formale pune në krahasim me punëtorët me pagesë dhe rrogë.

Meshkujt kanë më shumë gjasa të mbajnë punë të tilla të paqëndrueshme (25.8% e meshkujve të punësuar krahasuar me 18.4% të femrave të punësuar). Shprehur në numra absolutë, 83,988 nga 348,227 të punësuar i përkasin kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm (Tabela 1.5). Të punësuarit në fusha profesionale kanë më pak gjasa të jenë të punësuar në punë të paqëndrueshme (Tabela 1.6), si dhe personat me nivel të lartë arsimimi (Tabela 1.7).

Tab. 1.5: Punësimi i paqëndrueshëm sipas gjinisë

Kosovë	
PUNËSIM I PAQËNDRUESHËM (NË MIJËRA)	
Meshkuj	69.8
Femra	14.2
Të gjithë	84.0
PËRQINDJA E PUNËSIMIT TË PAQËNDRUESHËM NË PUNËSIMIN E PËRGJITHSHËM (%)	
Meshkuj	25.8
Femra	18.4
Të gjithë	24.1

Tab. 1.6: Punësimi i paqëndrueshëm sipas profesionit dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
TË VETËPUNËSUAR PA PUNONJËS TË TJERË (%)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	2.5	0.0	2.2
Profesionistë	2.3	0.9	2.1
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	1.5	0.0	1.3
Nëpunës	1.4	0.0	1.2
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	18.7	20.9	19.0
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	13.4	1.0	11.5
Punëtorë zejtarie dhe të ngjajshëm me ta	21.2	68.6	28.3
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	9.4	1.1	8.1
Profesione elementare	29.7	7.5	26.4
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
PUNËTORË FAMILJARË TË PAPAGUAR (%)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	1.6	1.7	1.6
Profesionistë	1.4	4.9	2.1
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	0	3.6	0.8
Nëpunës	0.4	0.0	0.3
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	20.6	19.3	20.3
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	9.7	7.6	9.2
Punëtorë zejtarie dhe të ngjajshëm me ta	21.3	5.8	18.0
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	4.3	0.0	3.4
Profesione elementare	40.9	57.2	44.3
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Tab. 1.7: Punësimi i paqëndrueshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
TË VETËPUNËSUAR PA PUNONJËS TË TJERË (%)			
Pa shkollë	0.2	2.9	0.6
Fillor	31.8	65.6	36.9
Arsim i mesëm profesional	32.0	17.5	29.8
Shkollë e mesme gjimnazi	27.2	13.0	25.1
Terciar	8.8	0.9	7.6
Gjithsej	100.0	100.0	100
PUNËTORË FAMILJARË TË PAPAGUAR (%)			
Pa shkollë	0.0	0.0	0.0
Fillor	25.7	66.4	34.2
Arsim i mesëm profesional	41.9	15.1	36.3
Shkollë e mesme gjimnazi	25.2	10.5	22.1
Terciar	7.2	8.0	7.4
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

1.5: Llojet e kontratave

Për sa i përket llojit të kontratës, që kishin të punësuarit e intervistuar, shumica (76.6%) kishin një kontratë individuale, ndërsa pjesa tjetër punonin pa kontratë. Për të rinjtë e moshës (15 deri 24 vjeç), përqindja e atyre që punonin pa kontratë ishte 48.8 %.

Nga personat, që kishin kontratë pune, vetëm 31.1 % kishin një kontratë të përhershme për punën e tyre kryesore, ndërsa 68.9% kishin kontrata të përkohshme. Shifrat janë të ngjashme për meshkujt dhe femrat. Personat, që kishin kontrata të përkohshme, u pyetën se pse ata kishin këtë lloj kontrate dhe 97.4% e të intervistuarve raportuan se nuk kishte asnjë lloj tjetër kontrate në dispozicion.

Kur u pyetën nëse kishin të drejtë, në punën e tyre kryesore, të përfitimit nga një skeme e sigurimeve sociale në punë, të dhënat nga anketa treguan se vetëm 5.4 % e punonjësve e kishin këtë të drejtë.

1.6: Punësimi sipas aktiviteteve

Tregtia, prodhimi, ndërtimtaria dhe arsimit punësonin më shumë se gjysmën e personave të punësuar në tremujorin e parë të vitit 2017 (tabelat 1.8 dhe 1.9). Tregtia punësonte 14.2%, duke vazhduar me prodhimin 13.4%, ndërtimtarinë 11.2% dhe arsimin 9.6 % të personave të punësuar në Kosovë.

Arsimi, kujdesi shëndetësor dhe tregtia ishin tre punëdhënësit kryesorë për femrat (duke punësuar pothuajse 50.0% të femrave të punësuar). Prodhimi, ndërtimtaria dhe tregtia janë sektorët më të zakonshëm të punësimit për meshkujt (duke punësuar 43.8 % të meshkujve të punësuar).

Tab. 1.8: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në mijëra)

Kosovë (mosha 15 e më shumë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	14.5	2.9	17.5
Minierat dhe xehroret	4.4	0.2	4.6
Prodhimi	41.6	5.4	47.0
Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	6.2	0.5	6.7
Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	4.8	0.1	4.9
Ndërtimtari	39.0	0.3	39.3
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjesh dhe motoçikletash	39.0	10.9	49.9
Transport dhe depozitim	8.3	0.5	8.8
Aktivite akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	19.8	2.5	22.3
Informim dhe komunikim	5.4	1.3	6.8
Aktivite financiare dhe sigurimesh	4.6	2.1	6.8
Aktivite me prona të paluajtshme	0.2	0.1	0.3
Aktivite profesionale, shkencore dhe teknike	6.9	2.4	9.3
Aktivite administrative dhe shërbime mbështetëse	9.4	1.7	11.1
Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	18.2	5.5	23.7
Arsimi	19.0	14.8	33.8
Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	10.9	13.0	23.9
Arti, zbavitja dhe rekreacioni	4.3	1.2	5.5
Aktivite të shërbimeve të tjera	12.2	4.9	17.0
*Aktivite të punësimit shtëpiak	2.2	6.3	8.5
Aktivite të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	2.2	1.1	3.3
Gjithsej	273.1	77.8	350.8

Tab. 1.9: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në %)

Kosovë (mosha 15 e më shumë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	5.3	3.8	5.0
Minierat dhe xehroret	1.6	0.2	1.3
Prodhimi	15.2	6.9	13.4
Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	2.3	0.7	1.9
Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	1.7	0.2	1.4
Ndërtimtari	14.3	0.4	11.2
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjesh dhe motoçikletash	14.3	14.0	14.2
Transport dhe depozitim	3.0	0.7	2.5
Aktivite akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	7.2	3.3	6.4
Informim dhe komunikim	2.0	1.7	1.9
Aktivite financiare dhe sigurimesh	1.7	2.7	1.9
Aktivite me prona të paluajtshme	0.1	0.1	0.1
Aktivite profesionale, shkencore dhe teknike	2.5	3.1	2.6
Aktivite administrative dhe shërbime mbështetëse	3.4	2.1	3.2
Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	6.7	7.1	6.7
Arsimi	7	19.0	9.6
Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	4	16.8	6.8
Arti, zbavitja dhe rekreacioni	1.6	1.5	1.6
Aktivite të shërbimeve të tjera	4.5	6.3	4.9
Aktivite të punësimit shtëpiak	0.8	8.1	2.4
Aktivite të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	0.8	1.4	0.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

1.7: Punësimi sipas profesioneve

Në tremujorin e parë të vitit 2017, shumica e të punësuarve kishin pozita pune në shërbime dhe shitje, në profesione elementare, si profesionistë dhe si punëtorë zejtarie (Tabela 1.10).

Pothuaj gjysma e femrave të punësuar ishin profesioniste, teknike dhe profesione që lidhen me to (41.6%), 16.5% në profesione elementare dhe 15.3% ishin në shërbime dhe shitje. Meshkujt ishin më të shpërndarë nëpër sektorë, por shumica ishin të punësuar në profesione elementare (24.5%), 18.5% punonin si punonjës në shërbime dhe shitje, 16.1% si punëtorë zejtarie dhe te ngjashëm me të kurse 9.9% ishin profesionistë (Tabela 1.10).

Tab. 1.10: Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë (në %)

Kosovë (mosha 15 e më shumë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI SIPAS PROFESIONEVE (NË MIJËRA)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	22.0	3.7	25.7
Profesionistë	27.1	22.4	49.4
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	17.5	10.0	27.5
Nëpunës	13.1	7.0	20.1
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	50.6	11.9	62.5
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	10.5	0.5	11.0
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	43.9	8.6	52.5
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	21.6	0.9	22.4
Profesione elementare	66.9	12.8	79.7
Gjithsej	273.1	77.8	350.8
PUNËSIMI SIPAS PROFESIONEVE (NË %)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	8.0	4.8	7.3
Profesionistë	9.9	28.7	14.1
Teknikë dhe profesione të lidhura	6.4	12.9	7.8
Nëpunës	4.8	9.0	5.7
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	18.5	15.3	17.8
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	3.9	0.7	3.1
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	16.1	11.1	15.0
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montatorë	7.9	1.1	6.4
Profesione elementare	24.5	16.5	22.7
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

*Profesionet elementare përfshijnë pastrues dhe ndihmës, punëtorë të bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit, punëtorë të minierave, ndërtimit, prodhimit industrial, transportit, asistentë të përgatitjes së ushqimit, punëtorë të shitjeve në rrugë, punëtorët e pastrimit të mbetjeve urbane dhe punëtorë të tjerë elementarë (ISCO 88 COM).

1.8: Modelet e punës

Vetëm 2.5 % e popullsisë së punësuar kanë raportuar se kishin një punë të dytë gjatë javës referente. Shkalla e punësimit për punë të dytë ishte më e lartë për meshkuj se sa për femra: 2.9 % të meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 1.1 % të femrave po ashtu në moshë pune.

Në punën e tyre kryesore, 93.5 % e të intervistuarve raportuan se punojnë me orar të plotë dhe 6.5% me orar të pjesshëm/orar të shkurtuar. Janë vërejtur dallime gjinore, me më shumë gjasa që femrat të punojnë me orar të pjesshëm (11.0% krahasuar me 5.3%).

Për ata që bëjnë punë me orar të pjesshëm, arsyet dallonin midis dy gjinive, gratë marrin një rol më të madh kujdesi brenda familjes duke reduktuar kështu orët në dispozicion për të punuar (Tabela 1.11). Arsyeja numër një për meshkujt pse nuk punojnë me orar të plotë, ishte mungesa e disponueshmërisë së punës me orar të plotë.

Tab. 1.11: Arsyet e të punuarit me orar të pjesshëm sipas gjinisë (%)

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Kujdesi për fëmijët apo të rriturit me aftësi të kufizuar	0.0	4.1	1.4
Invaliditet ose sëmundje	0.0	0.0	0.0
Arsye të tjera personale ose familjare	0.0	59.3	20.7
Është student	9.8	7.7	9.1
Nuk ka mundësi të gjejë punë me orar të plotë	83.9	26.0	63.7
Nuk dëshiron një punë me orar të plotë	0.0	0.0	0.0
Arsye tjetër	6.2	2.9	5.1
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Përafërsisht tri të pestat e të punësuarve kanë punuar midis 40-48 orë në javë. Pothuajse dy të dhjetat (12.5%) e të punësuarve kanë punuar 60 ose më shumë orë në javë. Brenda një jave, 20.9 % e të punësuarve kanë punuar më pak se 40 orë.

Meshkujt priren të punojnë me orare më të gjata se femrat, 24.6 % e meshkujve punojnë më shumë se 48 orë në javë krahasuar me 7.6 % të femrave (Tabela 1.12). Një pjesë më e madhe e femrave të punësuarra (26.8%) ka punuar më pak se 40 orë në krahasim me 19.2 % e meshkujve.

Tab. 1.12: Punësimi sipas orëve të punës në javë dhe sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI SIPAS NUMRIT TË ORËVE (NË MJËRA)			
Më pak se 25	37.1	15.5	52.6
25-34	12.3	4.4	16.7
35-39	2.6	0.8	3.4
40-48	152.4	50.7	203.1
49-59	25.6	3.3	28.9
60 e më shumë	40.9	2.6	43.5
Gjithsej	270.9	77.3	348.2
PUNËSIMI SIPAS NUMRIT TË ORËVE (NË %)			
Më pak se 25	13.7	20.1	15.1
25-34	4.5	5.7	4.8
35-39	1.0	1.0	1.0
40-48	56.2	65.6	58.3
49-59	9.5	4.2	8.3
60 e më shumë	15.1	3.4	12.5
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Të intervistuarit, që punojnë në sektorin publik, kanë raportuar orar më të shkurtër të punës se ata në sektorin privat (Tabela 1.13). Meshkujt dhe femrat, që punojnë në kompani private, kanë punuar me orare më të gjata krahasuar me të gjitha llojet e punësimit.

Tab. 1.13: Numri mesatar i orëve të punuara në javë sipas llojit të punëdhënësit dhe gjinisë

Kosovë	Sektori publik, qeveria	Ndërmarrje në pronësi	Kompani private	Individuale private
Meshkuj	37.7	38.1	46.6	38.8
Femra	35.3	33.3	43.7	35.0
Gjithsej	36.9	36.7	46.1	37.9

Gjasat janë më të vogla që femrat të punojnë me ndërrime, gjatë ndërrimeve të natës, mbrëmjeve dhe fundjavave por pak më të mëdha që të punojnë nga shtëpia (Tabela 1.14).


Tab. 1.14: Modelet e punësimit sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
NËSE PUNON ME NDËRRIME			
Punon me ndërrime	21.3	17.9	20.4
Nuk punon me ndërrime	78.7	82.1	79.6
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON MBRËMJEVE			
Zakonisht	15.7	14.1	15.4
Ndonjëherë	27.1	19.4	25.4
Kurrë	57.2	66.4	59.3
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON NATËN			
Zakonisht	2.7	0.0	2.1
Ndonjëherë	10.8	7.3	10.0
Kurrë	86.5	92.7	87.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON TË SHTUNAVE			
Zakonisht	39.2	29.1	37.0
Ndonjëherë	36.0	21.2	32.7
Kurrë	24.8	49.7	30.3
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON TË DIELAVE			
Zakonisht	6.0	11.6	7.2
Ndonjëherë	30.8	15.0	27.3
Kurrë	63.2	73.4	65.5
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
NËSE PUNON NË SHTËPI			
Zakonisht	6.3	10.9	7.3
Ndonjëherë	9.7	11.6	10.1
Kurrë	83.9	77.6	82.5
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

1.9: Paga mujore neto

Shumica e pagave mujore neto ishin midis 400 € dhe 500 €, në mesin e atyre që u përgjigjën. Janë vërejtur dallime shumë të vogla gjinore, me një tendencë të lehtë që meshkujt të marrin paga më të larta

Graf. 1.2: Paga mujore neto për punonjësit sipas gjinisë



2. Papunësia


2.1: Papunësia sipas gjinisë

Sipas tremujorit të parë të AFP-së 2017 në Kosovë ka pasur 152,915 persona të moshës 15-64 vjeç, që ishin të papunë, 112,084 nga të cilët ishin meshkuj dhe 40,830 femra (Tabela 2.1). Shkalla e papunësisë ishte 30.5 %, më e lartë ishte tek femrat me 34.6% se sa te meshkuj, 29.3 % (Graf. 2.1).

Krahasuar me tremujorin paraprak të AFP-së (TM4-2016) në Kosovë, kemi rritje të shkallës së papunësisë me 1.8%, ku kjo rritje te meshkujt ishte 2.4% përderisa te femrat kjo rritje është vetëm 0.3%.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM1-2016) të AFP-së në Kosovë, kemi rritje të shkallës së papunësisë me 2.8%, ku kjo rritje te meshkujt ishte 2.4% përderisa te femrat kemi rritje prej 4.6%.

Graf. 2.1: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë



Tab. 2.1: Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)			
15-64	112.1	40.8	152.9
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
15-64	29.3	34.6	30.5

2.2: Papunësia sipas grup moshës dhe nivelit arsimor

50.5 % e popullsisë së re në Kosovë ishin të papunë (Tabela 2.2). Shkalla më e ulët e papunësisë është hasur në mesin e personave të moshës 55-64 vjeç (11.0%).

Tab. 2.2. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grup moshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)			
15-24	26.4	13.8	40.2
25-34	40.1	16.7	56.8
35-44	25.2	6.8	32.0
45-54	14.6	2.9	17.4
55-64	5.8	0.6	6.5
15-64	112.1	40.8	152.9
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
15-24	46.5	60.4	50.5
25-34	37.2	48.7	40.0
35-44	27.5	24.6	26.9
45-54	18.9	11.8	17.2
55-64	11.7	6.9	11.0
15-64	29.3	34.6	30.5

Shkalla e papunësisë ishte më e larta për personat e pashkolluar (45.2% e këtij grupi ishin të papunë) dhe më e ulta për personat që kishin përfunduar arsimin e lartë (21.2%).

Tabela 2.3. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)			
Pa shkollë	0.5	0.1	0.5
Fillor	29.1	4.2	33.2
Arsim profesional i mesëm	47.6	13.5	61.1
Shkollë e mesme gjimnazi	23.9	8.4	32.3
Terciar	11.1	14.7	25.8
Totali	112.1	40.8	152.9
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
Pa shkollë	58.5	21.0	45.2
Fillor	38.3	22.0	35.0
Arsim profesional i mesëm	32.2	42.8	34.1
Shkollë e mesme gjimnazi	28.3	41.8	30.9
Terciar	15.0	31.1	21.2
Totali	29.3	34.6	30.5

Shkollimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës, në veçanti për meshkujt pasi 58.5 % e meshkujve të pashkolluar ishin të papunë, në krahasim me 15.0 % të atyre që kishin përfunduar arsimin terciar.

2.3: Papunësia tek të rinjtë

Bazuar në tremujorin e parë të AFP-në e vitit 2017, 26.3% e të papunëve në Kosovë ishin të rinj (të moshës 15-24 vjeç) me 10.4 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave.

Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së re është e papunë (50.5%) dhe shkalla e papunësisë tek rinia e gjinisë femërore është më e lartë (60.4 %) krahasuar me meshkujt (46.5%).

Tab. 2.4: Përqindja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme dhe shkalla e papunësisë tek të rinjtë sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Përqindja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme (%)	23.5	33.9	26.3
Përqindja e të rinjve si të papunë në popullsinë e re (%)	46.5	60.4	50.5

Në tremujorin e parë të vitit 2017, të rinjtë në Kosovë kishin dy herë më shumë gjasa të ishin të papunë në krahasim me të rriturit, me shifra pothuajse të ngjashme për meshkujt dhe femrat (Tabela 2.5).

Tab. 2.5: Shkalla e papunësisë së të rinjve ndaj të rriturve, sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkalla e papunësisë së të rinjve ndaj papunësisë së të rriturve	1.8	2.1	1.9

2.4: Kohëzgjatja e papunësisë

Të intervistuarit e papunë janë pyetur për sa kohë janë të papunë. Një numër i madh (69.2%) i te papunëve raportuan se janë të papunë për më gjatë se 12 muaj. Janë vërejtur dallime të vogla gjinore (69.9% e meshkujve dhe 67.2% e femrave).


(Tabela 2.6) tregon se gjasat për të qenë i/e papunë për më shumë se një vit rriten me moshën.

Tabela 2.6: Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%)

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
15-19	37.3	50.3	41.4
20-24	57.0	60.9	58.3
25-29	73.9	61.2	70.0
30-34	71.3	78.7	73.3
35-39	65.7	88.0	70.7
40-44	75.5	71.3	74.7
45-49	86.8	81.3	85.6
50-54	88.3	77.4	87.2
55-59	76.3	17.3	69.3
60-64	88.5	100.0	89.0
Gjithsej	69.9	67.2	69.2

Grafikoni 2.2. tregon se grup moshë 30-34 edhe pse grup moshë e re, te femrat papunësia për më shumë se një vit arrin 78.7% krahasuar me 71.3% te meshkujt.

Graf. 2.2. Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%)




3. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore

Në tremujorin e parë të vitit 2017, nga popullsia e përgjithshme e përllogaritur prej 1,793,467, popullsia e përgjithshme në moshë pune (15 deri 64 vjeç) ishte 1,202,982 persona. 41.7% e personave në moshë pune merrnin pjesë në fuqinë punëtore (ekonomikisht aktivë). Kjo do të thotë se ata ishin ose të punësuar ose të papunë (por aktivë në kërkim të një pune dhe të gatshëm për punë). Pjesa tjetër prej 58.3% ishin ekonomikisht joaktivë (Graf. 4.1). Personat ekonomikisht joaktivë përfshijnë studentët, amviset, punonjësit e dekurajuar dhe persona të tjerë, të cilët nuk ishin aktivë në kërkim të një pune dhe kjo kategori shqyrtohet më hollësisht në kapitullin e ardhshëm.

Krahasuar me tremujorin paraprak të AFP-së (TM4-2016) në Kosovë, kemi rritje të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore me 0.4%, ku kjo rritje te meshkujt ishte 0.7% përderisa te femrat kjo rritje është vetëm 0.2%.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM1-2016) të AFP-së në Kosovë, kemi rritje të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore me 6.5 %, ku kjo rritje te meshkujt ishte 10.3 % përderisa te femrat ishte vetëm 2.4 %.

Graf. 3.1: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë



Nga grafikoni 3.1 është e qartë se pjesëmarrja në fuqinë punëtore në mesin e femrave ishte shumë më e ulët se në mesin e meshkujve: 19.8 % e femrave ishin aktive në krahasim me 63.1 % e meshkujve.

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ishte më e larta në mesin e personave të moshës 30-34 vjeç (58.7 %) dhe më e ulët në mesin e personave të moshës 15 deri 19 vjeç me 8.9 % (Tabela 3.1). Shkalla e ulët e pjesëmarrjes së të rinjve nuk është për t'u habitur sepse shumica e këtij grupi ndjekin shkollën.

Tek meshkujt, moshat 30-34 vjeç kishin shkallë më të lartë pjesëmarrjeje (86.9 %), ndërsa për femrat shkalla më e lartë ishte në grup moshën, 25-29 vjeç (31.0 %) (Tabela 3.1).

Tab. 3.1: Fuqia punëtore dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhe grupmoshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia Punëtore (në mijëra)			
15-19	12.1	4.3	16.4
20-24	44.5	18.6	63.2
25-29	57.6	19.6	77.3
30-34	49.9	14.7	64.6
35-39	44.6	12.5	57.1
40-44	47.1	15.1	62.1
45-49	39.2	14.2	53.4
50-54	38.0	10.1	48.1
55-59	30.8	5.5	36.3
60-64	19.0	3.6	22.6
Totali 15 - 64	383.0	118.2	501.1
Shkalla e Pjesëmarrjes në Fuqinë Punëtore (%)			
15-19	13.0	4.7	8.9
20-24	50.4	23.5	37.7
25-29	76.9	31.0	55.9
30-34	86.9	27.9	58.7
35-39	83.3	22.8	52.6
40-44	84.8	24.8	53.4
45-49	82.0	22.7	48.5
50-54	71.3	18.7	44.8
55-59	67.0	12.2	39.9
60-64	52.3	11.0	32.7
Totali 15 - 64	63.1	19.8	41.7

4. Personat joaktivë


Vëmendje e veçantë i është kushtuar përshkrimit dhe vlerësimit të popullsisë së punësuar dhe asaj të papunë, që së bashku përbëjnë Fuqinë Punëtore (ose personat ekonomikisht aktivë). Megjithatë, kategoria “joaktivë” është po aq e rëndësishme. Ndryshimet në shkallën e aktivitetit janë pjesë e rëndësishme e ndikimit të ofertës së punës në rritjen potenciale ekonomike. Kjo për shkak të numrit të madh të punëtorëve potencialë në mesin e personave aktualisht joaktivë.

Krahasuar me tremujorin paraprak të AFP-së (TM4-2016) në Kosovë, kemi ulje të shkallës së jo aktivitetit me 0.4%, ku kjo ulje te meshkujt ishte 0.7% përderisa te femrat kjo ulje është vetëm 0.2%.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM1-2016) të AFP-së në Kosovë, kemi ulje të shkallës së jo aktivitetit me 6.5 %, ku kjo ulje te meshkujt ishte 10.3 % përderisa te femrat ishte 2.4 %.

Nga graf. 4.1 është e qartë se pjesëmarrja më e madhe është në mesin e femrave se në mesin e meshkujve: 80.2% e femrave ishin jo aktive në krahasim me 36.9% e meshkujve.

Graf 4.1: Shkalla e pjesëmarrjes jo aktive sipas gjinisë



4.1: Të rinjët joaktivë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)

Të rinjtë e këtij grupi (NEET) përfshijnë të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën, as nuk trajnohen, d.m.th. janë krejtësisht të shkëputur nga tregu i punës dhe nuk marrin pjesë as në sistemin arsimor. Përqindjet e larta të këtij grupi në popullsinë e të rinjve rrisin shqetësimet në lidhje me punësimin e të rinjve në të ardhmen pasi tregon shkëputje nga tregu i punës. Përveç kësaj, një numër i madh i të rinjve të pa angazhuar në vendet me papunësi të lartë të të rinjve, siç është Kosova, mund të shkaktojë uljen e fitimeve për shkak të rritjes së konkurrencës, si dhe ka mundësi t'i kontribuojë problemeve sociale.

Në tremujorin e parë të vitit 2017, 97,910 të rinj (të moshës 15 deri 24) në Kosovë nuk ndiqnin shkollimin, nuk ishin të punësuar apo në trajnim dhe përbënin 27.8 % të popullsisë së re. Pjesa e femrave NEET është 31.8% krahasuar me 24.1% të meshkujve (Tabela 4.2).

Tab. 4.1: Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollë ose trajnim (NEET) sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Të rinj NEET (në mijëra)	43.9	54.0	97.9
Përqindja e të rinjve NEET në popullsinë e re (%)	24.1	31.8	27.8

5. Shkallët e varësisë demografike dhe ekonomike

Në Tabelën 5.1 janë paraqitur tri shkallë të varësisë ekonomike (me të dhënat e paraqitura si përqindja e të varurve për 100 nga popullsia në moshë pune):

- Shkalla e varësisë së të rinjve (të intervistuarit e moshës nën 15/të intervistuarit e moshës 15-64)
- Shkalla e varësisë së të moshuarve (të intervistuarit e moshës 65+/ të intervistuarit e moshës 15-64)
- Shkalla e varësisë moshore (të intervistuarit më të rinj se 15 ose më të vjetër se 64/ të intervistuarit e moshës 15-64).

Tab. 5.1: Shkallët e varësisë demografike

Kosovë 2017	Shkalla e varësisë së të rinjve	Shkalla e varësisë së të moshuarve	Shkalla e varësisë moshore
TM1-2017	34%	14%	49%

Një shkallë tjetër e përdorur shpesh, në veçanti në publikimet e Eurostat-it, është shkalla e varësisë efektive ekonomike e të moshuarve. Ky është një indikator i rëndësishëm për vlerësimin e ndikimit potencial të moshës së shtyrë në shpenzimet sociale, që lidhen me punësimin (pensionet etj.). Ky indikator kalkulohet si raport midis popullsisë së moshës 65+ (të gjithë të klasifikuar si joaktive) dhe punësimit të përgjithshëm. Për këtë raport Eurostat-i ka vendosur gamën e moshës për të punësuarit nga 20 deri në 64 vjeç. Sipas projeksioneve, ky indikator do të rritet në 68 % në vitin 2060 në BE28. Në Kosovë ky raport ishte 49 % për tremujorin e parë të vitit 2017.

Tab. 5.2: Shkallët e varësisë ekonomike

Kosovë 2017	Shkalla e varësisë efektive ekonomike e të moshuarve	Shkalla totale e varësisë ekonomike
TM1-2017	52%	257%

Shkalla totale e varësisë ekonomike kalkulohet si raport midis popullsisë së përgjithshme joaktive (15+) dhe punësimit (20-64 vjeç). Ai mat numrin mesatar të personave të moshës 15 vjeç e më shumë, që "përkrah" secili i punësuar. Ky raport ishte 257% në tremujorin e parë të vitit 2017.

Sipas projeksioneve deri në vitin 2023 ky raport do të vazhdojë të rritet në BE, në 122.2% në vitin 2023 dhe 141.6 % në vitin 2060.

6. Saktësia e të dhënave

Besueshmëria dhe saktësia e rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) është e varur nga mungesa e përgjigjeve gjatë procesit të intervistimit, gabimeve gjatë përpunimit të të dhënave dhe gjatë dizajnit dhe përzgjedhjes së mostrës.

Efekti i rastësishëm për shkak të mostrimit do të thotë se rezultatet e llogaritura nga mostra të ndryshme devijojnë disi nga njëri-tjetri. Shifrat e të punësuarve dhe të papunëve, që janë nxjerrur të bazuara në një mostër më madhe dhe më representative janë më të sakta sesa ato që bazohen në mostra më të vogla.

Pasaktësia për shkak të dizajnit dhe përzgjedhjes së mostrës vlerësohet me gabimin standard të vlerësimit. Madhësia e gabimit standard ndikohet nga madhësia e mostrës dhe varianca e variablove që janë objekt studimi. Gabimi standard mund të përdoret për të llogaritur intervalin e besimit, brenda të cilit vlera e popullsisë qëndron me një probabilitet të caktuar. Vlerësimi në nivel vendi për numrin e të papunëve në bazë AFP-së për tremujorin e parë të vitit 2017 është 152,915 dhe gabimi i tij standard është 5,040 ndërsa intervali i besueshmërisë për numrin e të papunëve është 143,015-162,814 persona.

Tab. 6: Saktësia e vlerësimeve në bazë të AFP-së për tremujorin e parë të vitit 2017 në nivel vendi

Kosovë	Vlerësimet tremujore	Gabimi standard	Intervali i besueshmërisë 95%		Koefficienti i Variacionit (%)
			I ulët	I sipërm	
Të punësuar	348.227	6.858	334.758	361.697	2.0
Të papunë	152.915	5.040	143.015	162.814	3.3

Saktësia e vlerësimeve paraqitet në bazë të gabimit të tyre standard. Gabimi standard (rrënja katrore e variancës së mostrës) përshkruan se sa saktë vlera e parametrit të vlerësuar nga mostra është e përqendruar rreth parametrit të popullsisë.

Shifrat kryesore të besueshmërisë që rrjedhin nga gabimi standard janë intervalet e besueshmërisë dhe gabimi standard relativ (koefficienti i variacionit). Intervali i besimit përshkruan gjerësinë në të cilin vlera reale e parametrit është në raport me vlerësimin e llogaritur nga mostra. Kur llogaritni intervalin e besimit, niveli i dëshiruar i rrezikut është i fiksuar. Niveli i rrezikut prej 5 për qind i aplikuar në anketën e fuqisë punëtore nënkupton që nëse mostrat do të tërhiqen përsëri, në 95 raste nga njëqind, vlera reale e parametrit do të ishte brenda intervalit të besimit dhe në 5 raste nga njëqind do të të jetë jashtë intervalit të besimit.

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruer terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rrgjistrimi i Bujqësisë . Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>